

**Manuali i Proçeseve për Shërbimet e ONE Albania:  
Shërbimet e Aksesit LLU**

**Aksesi i Përbashkët në Rrjetin Lokal (ULMP)  
&  
Shërbimet e Aksesit (LLU)**

**Bazuar në Ofertën Referencë Të  
Aksesit Të ONE Albania**

**Plani i Shërbimeve  
102, 103 & 10**

## Pasqyra e Lëndës

1	Hyrje .....	6
1.1	Objekti .....	6
1.2	Shkurtimet .....	6
1.3	Përshkrimi i Shërbimeve .....	7
1.4	Proçesi i Ndryshimit të Menaxhimit .....	7
1.5	Përkufizimet .....	7
1.6	Porta Aksesit e Unifikuar (UG) .....	8
1.7	Numër Llogarie Universale dhe Numri Referencës Qarkut.....	8
2	Përshkrim i Proçesit .....	8
2.1	Ofrimi i Shërbimit .....	8
2.2	Riparimi i Defektit.....	8
2.3	Faturimi.....	9
2.4	Njoftimi Humbjeve.....	9
3	Ofrimi i Shërbimit .....	9
3.1	Komunikimi ndërmjet Shitjeve me Shumicë të ONE Albania dhe Kërkuarit të aksesit ( AS).....	9
3.1.1	Roli i Qendrës së Porosisë LLU .....	9
3.1.2	Ndërveprimi me Qendrën e Porosisë LLU.....	10
3.2	Identifikimi i Qarkut .....	10
3.2.1	Porosia PU .....	10
3.2.2	Porosia PUI .....	11
3.2.3	Porosia PUS .....	11
3.3	Ofrimi i të Dhënave të Linjës .....	11
3.4	Kushtet paraprake.....	11
3.4.1	Autorizimi i Klientit .....	11
3.5	Shërbimet Konkuruuese & Perjashtimet.....	11
3.6	Fazat e Proçesit.....	12
3.7	Afati i implementimit.....	12
3.8	Pika e Terminimit e Rrjetit Lokal.....	12
3.9	Përgjegjësia për Instalimet Kablore në Ambjentet e Klientit.....	12
3.10	Porositë .....	13

3.10.1	Llojet e Porosive .....	13
3.11	Lloji i Porosive të Ofrimit .....	13
3.12	Porosia për ndërprerje .....	13
3.13	Lloji i Porosisë “Transferim” .....	13
3.14	Lloji i Porosisë “Konvertim I askesit te perbashket LS në akses te plote ULMP” ....	14
3.15	Lloji i Porosisë “Anullim” .....	14
3.16	Lloji i Porosisë “Linja per kerkim te dhenash DRL” .....	14
3.17	Lloji i Porosisë “Ndryshim Porte” .....	14
3.18	Lloji i Porosisë së “Inspektimit të Linjës LLU” .....	14
4	Llojit i Porosisë Ofrim Shërbimi .....	14
4.1	Parashikimi i një porosie ULMP (PU) .....	14
4.2	Ofrimi një Porosie Rrjeti në Vend (PUI) .....	14
4.3	Ofrimi i Linjës së Re ose porosia linjë Rezerve (PUS).....	15
4.4	Ofrimi i porosisë se Aksesit të Përbashket (PLS) .....	15
4.5	Dërgimi i Porosisë.....	15
4.6	Aprovimi i Porosisë .....	15
4.6.1	Përkufizimi .....	15
4.6.2	Kontrollet e Vlerësimit të Porosisë .....	16
4.6.3	Testimi i Linjës dhe Kategorizimi i Linjës.....	17
4.6.4	Nevoja e Inspektimit.....	17
4.6.5	Linja me CPS.....	17
4.6.6	Përgjigja e Vlerësimit .....	17
4.6.7	Porosia e Pranuar .....	17
4.6.8	Porosia e Refuzuar .....	17
4.7	Përgatitja e Linjës .....	17
4.7.1	Riparimi i Kabllit .....	18
4.7.2	Instalimi i NTUs.....	18
4.7.3	Aksesi i përbashkët në Linjë (PLS) .....	18
4.8	Lidhja (Jumpering) .....	18
4.9	Proçesi i percaktimit për Porositë PUS.....	19
4.9.1	Proçesi Manual I Kontaktit të Klientit .....	19

4.10	Proçesi i Identifikimit të Linjës në ambientet e klientit .....	20
4.11	Plotësimi .....	20
4.12	Porosia e Plotësuar me Sukses .....	20
4.12.1	Mosofrimi .....	20
4.13	Njoftimi i humbjes.....	21
5	Ndërprerja e llojit të porosisë.....	21
5.1	Paraqitja porosisë .....	21
5.2	Vlefshmeria e porosisë .....	21
5.3	Pranimi / Refuzimi i porosisë.....	21
5.4	Përfundimi I porosisë .....	21
5.5	E padërgueshme .....	21
6	Anullimi I llojit të porosisë .....	22
6.1	Dritarja e anulimit.....	22
6.2	Dorëzimi i porosisë .....	22
6.3	7.3 Miratimi/Anulimi i porosisë.....	22
7	Lloji i porosisë së konvertimit të LS në ULMP .....	22
7.1	Para-sigurimi I pajisjes se aksesit .....	23
7.2	Paraqitja e porosisë .....	23
7.3	Miratimi i porosisë .....	23
7.4	Pranimi i porosisë .....	23
7.4.1	Ndërprerja e qarkut.....	23
7.5	Refuzimi i porosisë.....	24
7.6	NTU .....	24
7.7	Lidhje (Jumpering) .....	24
7.7.1	Detajet e block and pin .....	24
7.8	Përfundimi .....	24
7.8.1	Porosia e përfunduar me sukses.....	24
7.8.2	E padërgueshme .....	24
8	Lloji I porosisë për Linjën e Kërkimit të të Dhënave.....	24
8.1	Paraqitja e porosisë .....	25
8.2	Kategorizimi i linjës .....	25

8.3	Dërgimi I të dhënave shtesë .....	25
9	Transfera e AS dhe proçesi I kthimit të fitimit me pakicë të ONE Albania.....	25
9.1	Sigurimi I porosisë së transferimit të ULMP.....	25
9.2	Sigurimi i transferimit të porosisë së LS .....	25
9.3	Paraqitja e porosisë .....	26
9.4	Vlefshmeria e porosisë .....	26
9.4.1	Përgjigjja e miratimit.....	26
9.4.2	Pranimi i porosisë .....	26
9.4.3	Refuzimi I porosisë .....	26
9.5	Përfundimi .....	26
9.5.1	Përfundimi me sukses i porosisë.....	26
9.5.2	E padërgueshme .....	26
9.6	Njoftimi I humbjes .....	27
10	Porosia për portën e ndryshimit.....	27
10.1	Paraqitja e porosisë .....	27
10.2	Miratimi i porosisë .....	27
10.3	Pranimi / Refuzimi i porosisë.....	27
10.4	Përfundimi I porosisë .....	27
10.5	E padërgueshme .....	27
11	Lloji i porosisë për linjën e kërkimit LLU.....	28
11.1	Paraqitja e porosisë .....	28
11.2	Miratimi I porosisë.....	28
12	Proçesi I njoftimi të humbjes.....	28
13	Letra për mostransferim .....	28
13.1	Qëllimi I letrës anti-slamming .....	28
13.2	Transferimi I Klientëve .....	28
13.3	Pretendimet për Transferim .....	29
14	Riparimi I defektit.....	29
14.1	Qëllimi.....	29
14.2	Parimet e raportimit të defektit .....	29
14.3	Lokalizimi I defekteve.....	29

14.3.1	Llojet e defekteve:.....	30
14.3.2	Defekti në bllokun OAO: .....	30
14.4	Raportimi i defektit .....	30
14.4.1	Orët e raportimit të defektit.....	30
14.5	Testimi i linjës .....	31
14.5.1	Shërbimi i Aksesit te perbashket LS.....	31
14.5.2	Shërbimi ULMP.....	31
14.5.3	Karakteristikat e testimit te Linjes.....	31
14.6	Defekti i Jumperit .....	31
14.7	Defektet në centralit.....	31
14.8	Statusi i defektit .....	31
14.9	Riparimi i defektit .....	31
14.10	Objektivat për riparimin e defektit .....	31
14.11	Proçesi i përshkallëzimit .....	32
14.12	Mosmarrëveshjet.....	32
14.13	Dyshimi i ndërhyrjes në linjë .....	32
15	Faturimi .....	33
15.1	Hyrje .....	33
15.2	Raporti i përdorimit.....	33
15.2.1	Përmbajtja e raportit të përdorimit .....	33

## 1 Hyrje

Ky dokument përmban një sërë procesesh operacionale që ndihmojnë ndërveprimin ndërmjet ONE Albania dhe operatorëve të tjerë të telekomunikacionit për shpërndarjen dhe operimin e dy shërbimeve të ofruara nga ONE Albania për të lejuar operatorët e tjerë të telekomunikacionit që të përdorin rrjetin e saj të bakrit të aksesit lokal.

### 1.1 Objekti

Këto procese aplikohen në shërbimin Akses i Përbashkët në Rrjetin Lokal (ULMP) dhe Linjë me Akses të Përbashkët (LS) siç është përcaktuar nga ONE Albania në Ofertën Referencë të Aksesit.

Objekti i këtij dokumenti është i kufizuar në proceset operacionale dhe në mënyrë specifike përjashton fushat si:

1. Standartet teknike që kanë të bëjnë me Rrjetin Lokal me Bashkëvendosje
2. Çmimi i shërbimeve të ofruara nga ONE Albania
3. Performancë e procesit dhe cilësia e shërbimit.

Në rast se Oferta Referencë e Aksesit të ONE Albania është ndryshuar, këto procese do të rishikohen dhe azhurnohen nëse është e nevojshme.

### 1.2 Shkurtime

Shkurtime e mëposhtme do të përdoren në këtë dokument:

AP	Ofruesi Aksesit
ARO	Oferta Referencë e Aksesit të ONE Albania. ARO aktuale është publikuar në ONE Albania website
AS	Kërkues Aksesi
CAF	Formulari i Autorizimit të Klientit
CLFMP	Plani i Menaxhimit të Frekuencave Linjës Dypërcjellëse të Bakrit
CPE	Paisja në Ambjentet e Pajtimtarit
CPS	Parazgjedhjes së Bartësit
CRN	Numri Referencës Qarkut ose Numri Telefonit të ONE Albania
DRL	Linja e Kërkimit të Dhënave
DSLAM	Moduli i Aksesit të Linjës Dixhitale të Abonentit
FTP	Protokolli i Transferimit të të Dhënave Protocol
IPM	Manuali i Proceseve të Industrisë
ISDN	Rrjeti Dixhital i Shërbimeve të Integruara
LLU Services	Shërbimet LLU
LS	Akses i përbashkët në rrjetin lokal
LTS	Sistemi i Testimit të Linjës
MDF	Permutatori
NDA	Marrëveshja e Konfidencialitetit
NTP	Pika e Terminimit të Rrjetit
NTU	Njësia e Terminimit të Rrjetit
OAD	Operatorët e Tjerë të Autorizuar
OSS	Sistemet e Suportit të Operimeve
PSTN	Rrjeti Telefonik Publik
SLA	Marrëveshja e Nivelit të Shërbimeve Shërbimeve

UAN	Numri i Llogarisë Universale
UG	Portë Aksesit e Unifikuar
ULMP	Akses i Plotë në Rrjetin Lokal
WTM	Menaxhimi i Problemeve të Shitjeve me shumicë

### 1.3 Përshkrimi i Shërbimeve

Ky seksion paraqet një përshkrim të shkurtër të Shërbimeve. Për një përshkrim më të detajuar, referojuni Ofertës Referencë të Aksesit të ONE Albania (ARO).

Shërbimet LLU i ofrohen Kërkuesit të Aksesit (AS) për ofrimin e shërbimeve të aksesit në rrjetin lokal të bakrit në ONE Albania

ONE Albania ka specifikuar tre shërbime në ARO; ky manual IPM lidhet me dy shërbimet e para, nga tre shërbimet e referuara më poshtë:

1. Shërbimi i Aksesit të Plotë në Rrjetin Lokal ULMP, që i ofrohet Kërkuesit të Aksesit AS për përdorim ekskluziv të një linjë metalike ndërmjet centralit të ONE Albania dhe ambjenteve të pajtimtarit.
2. Aksesit i përbashkët në rrjetin lokal që i ofrohet kërkuesit për përdorimin e përbashkët të linjës metalike ndërmjet Centralit ONE Albania dhe Ambjenteve të Pajtimtarit. ONE Albania ruan spektrin e frekuencave të bandës së zërit të qarkut dhe vazhdon të ofrojë shërbimin PSTN dhe Kërkuesit të Aksesit i mundësohet përdorimi i pjesës tjetër të spektrit të frekuencës.
3. Aksesit në Nën Rrjetin Lokal: Manuali i Proçeseve do të zhvillohet dhe pranohet në nivel industrie.

Kërkuesi i Aksesit mundet të ofrojë shërbime që janë në përputhje me Planin e Menaxhimit të Frekuencave.

Këto shërbime ofrohen në ndërthurje me facilitetet e bashkevendosjes fizike për aksesin e kërkuesit të aksesit (AS) dhe paisjen e rrjetin kryesor siç është përcaktuar në ARO<sup>1</sup>

### 1.4 Proçesi i Ndryshimit të Menaxhimit

Ky dokument është pjesë e dokumentave të bashkëngjitura, të quajtura:

1. Dokumentet e përshkrimit të produktit (shërbimet e skeduar)
2. Manuali i Proçeseve të Bashkëvendosjes
3. Manuali I Proçeseve të shërbimeve LLU
4. Marrëveshja e Nivelit të Shërbimit

Zhvillimi i këtij dokumenti mund të kerkojë në mënyrë të nevojshme ndryshime në dokumentat e tjera lidhur me të.

Seti i dokumentave do të rishikohet kur dhe si të konsiderohet e përshtatshme nga industria në mënyrë që problemet që evidentohen nga implementimi praktik i produkteve dhe proçeseve të mund të përdoren për të modeluar përshkrimet e produktit dhe marrëdhëniet e bashkëpunimit ndërmjet palëve.

### 1.5 Përkufizimet

Fjalët dhe shprehjet në këtë dokument janë sipas përcaktimeve në Ofertën Referencë të Aksesit (ARO).

<sup>1</sup> Physical Collocation for Unbundled Lokal Metallic Path / Linë Sharing, Service Schedule 101.



## **1.6 Porta Aksesi e Unifikuar (UG)**

UG është një sistem i menaxhimit të porosive dhe defekteve i dizenuar për të qenë ndërfaqja primare mes ONE Albania dhe operatorit tjetër kërkuar i aksesit. Ky sistem pranon dhe vlerëson porositë e kërkuarve të aksesit dhe kërkesa të tjera dhe mundëson përgjigjen e njoftimeve të duhura. Sistemi UG lejon ndërveprimin e palëve të treta mbi një sërë kanalesh aksesi. Për këtë qëllim mundësohen aksesi nëpërmjet FTP dhe aksesi online në web, ndërkohë që mund të shtohen edhe kanale shtesë kohë pas kohe në linjë me kërkesat e biznesit.

## **1.7 Numër Llogarie Universale dhe Numri Referencës Qarkut**

Shërbimi ULMP kërkon përdorimin e një Numri Llogarie Universale (UAN) dhe një Numri Referencë Qarku (CRN). CRN është përcaktuar si Numër Llogarie Universale ose numri i telefonit të ONE Albania. CRN alokohet në qark gjatë procesit të bërjes së porosisë. UAN është përcaktuar si Numër Llogarie Universale ose Numri i Llogarise së ONE Albania.

Kur kërkuar i aksesit (AS) kontraktin klientin për një linjë të re nëpërmjet një PUI ose PUS, atëherë nuk ka nevojë që të ofrohet UAN ose CRN kur dorëzohet porosia pasi ato nuk ekzistojnë. Megjithatë, si pjesë e procesit të porosisë të OAO ULMP ONE Albania, do të japë UAN dhe CRN si pjesë e plotësimit të njoftimit.

Në mënyrë tipike

- Numri i Llogarise së ONE Albania kur një klient shpërngulet nga ONE Albania tek LLU.
- Numri i Referencës së Qarkut kërkohet kur shpërngulja e një klienti nga LLU tek LLU.

Kërkuar i aksesit (AS) duhet të sigurojë që një formular i UAN dhe një formular i CRN të jenë të përfshirë në faturat e të gjithë operatorëve të tjerë OAO të lëshuara për pajtimtarin. Me kërkesën e klientit fundor, UAN dhe CRN do të komunikohen klientit brenda 2 ditëve punë. Klienti do të kërkojë UAN dhe CRN me qëllim që të zhvendoset ndërmjet operatorëve.

## **2 Përshkrim i Proçesit**

Shërbimet LLU kërkojnë disa proçese kryesore operacionale:

1. Ofrimi i Shërbimit
2. Riparimi i Defektit
3. Faturimi
4. Njoftimi Humbjeve

Secila nga Këto është përshkruar shkurtimisht me poshtë dhe në detaje në seksionet vijuese të këtij dokumenti.

### **2.1 Ofrimi i Shërbimit**

Ky proçes përshkruan rregullat për porositjen dhe ofrimin e një shërbimi LLU, përfshirë këtu edhe rregullat për të lidhur shërbimin e aksesit në rrjetin lokal të ONE Albania me paisjen e kërkuar të aksesit (AS)

### **2.2 Riparimi i Defektit**

Ky proçes përshkruan proçedurat që duhet të ndiqen nga kërkuar i aksesit (AS) kur raportin defekte për një shërbim LLU

### 2.3 Faturimi

Ky proces përshkruan rregullat për faturimin e kërkuarit të aksesit (AS) për shërbimet LLU dhe për zgjidhjen e çështjeve të faturimit.

### 2.4 Njoftimi Humbjeve

Ky proces përshkruan rregullat për njoftimin e ofruesit të shërbimit që një shërbim ekzistues është transferuar tek një ofrues tjetër shërbimi. Ajo gjithashtu lejon operatorin Humbës që të dërgojë një letër kundër përplasjes.

## 3 Ofrimi i Shërbimit

### 3.1 Komunikimi ndërmjet Shitjeve me shumicë të ONE Albania dhe Kërkuarit të aksesit (AS)

Shitja me shumicë e ONE Albania do ta pajisë kërkuarin e aksesit (AS) me një pikë të vetme kontakti për Ofrimin e Shërbimit.

Në tekstin e mëposhtëm, kjo i referohet Qendrës së Porosisë të LLU. Në të njëjtën mënyrë çdo kërkuar aksesit (AS) do të pajisë ONE Albania me një pikë të vetme kontakti për Ofrimin e Shërbimit. Qendra e Porosisë LLU do të jetë e hapur gjatë orarit normal zyrtar. Qendra e Porosisë LLU mund të kontaktohet nëpërmjet:

1. e-mail: [\\_\\_\\_\\_\\_@one.al](mailto:_____@one.al)
2. Telephone: \_\_\_\_\_

Në rast problemesh, ONE Albania dhe AS do të kërkojnë një proces përshkallëzimi siç është përshkruar në seksionin 3.8


#### 3.1.1 Roli i Qendrës së Porosisë LLU

Shitja me shumicë e ONE Albania do të operojë Qendrën e Porosisë LLU në emër të kërkuarit të aksesit (AS) dhe Shitjes me Pakicë të ONE Albania. Ajo do të funksionojë si "hub" për procesin e ofrimit të shërbimit siç është paraqitur në Figurën 3. Të gjitha komunikimet do të rrugëzohen nëpërmjet Qendrës së Porosisë LLU dhe nuk do të ketë komunikim direkt ndërmjet kërkuarit të aksesit (AS), përfshirë këtu edhe shitjen me Pakicë të ONE Albania.

Qendra e Porosisë LLU do të:

1. marrë porosi nga shitja me Pakicë e ONE Albania si dhe nga kërkuari i aksesit (AS)
2. të lëshojë instruksionet e punës për funksionet inxhinierike të ONE Albania
3. të lëshojë njoftimet e humbjes për ofruesit e shërbimit kur një konkurrent fiton biznes nga ata

Figure 3.1: Hub Function of LLU Ordering Centre



Komunikimi ndërmjet Qendrës së Porosisë LLU dhe shitjes me pakicë të ONE Albania do të jetë i njëjtë si ndërmjet Qendrës së Porosisë LLU dhe një kërkuesi aksesi (AS) (p.sh. Njoftimi I Humbjeve tek operatori humbës, etj)

### 3.1.2 Ndërveprimi me Qendrën e Porosisë LLU

Metoda e ndërveprimit me Qendrën e Porosisë LLU varet nga lloji i porosisë. Porta e Unifikuar (UG) do të përdoret për të porositur pjesën më të madhe të shërbimeve LLU. Kur një shërbim nuk është i mundshëm për tu porositur nëpërmjet UG, ky përjashtim do të theksohet në seksionin përkatës të këtij Manuali.

Llojet e Porosive UG janë si më poshtë vijon:

- 1 Porosia PU dhe PWU - Ofrimi i ULMP në Linjën(at) në Punë
  - Konvertimi i LS në ULMP – seksioni 7
  - Transferimi (PU) & PSTNsë in-back (PWU) – seksioni 9
- 2 Porosia PUI - Ofrimi i ULMP në Linjën(at) Insitu
- 3 Porosia PUS - Ofrimi i ULMP në Linjën(at) Rezerve
- 4 Porosia PLS - Ofrimi i aksesit të Përbashkët (LS)
- 5 Porosia CU - Ndërprerja ULMP
- 6 Porosia CLS - Ndërprerja e aksesit të Përbashkët (LS)
- 7 Porosia DRL – Linja për kërkesë të dhënash
- 8 Porosia CO - Anullo Porosinë
- 10 Porosia CHP – Porosi për Ndryshimin e Portës
- 11 Porosia ULE - Inspektimi i Linjës LLU
- 12 Porosia XLS - Transferimi i aksesit të Përbashkët (LS)

Llojet e Porosive Manuale janë:

- 1 Porosi për anulim - Seksioni 6

## 3.2 Identifikimi i Qarkut

### 3.2.1 Porosia PU

Për Porositë për shërbimet LLU lidhur me linjat ekzistuese PSTN të ONE Albania, ONE Albania do të përdorë numrin ekzistues PSTN, adresën teknike të linjes si identifikues qarku, CRN – Numri i Referencës së Qarkut, për rrjetin lokal të përbashkët. Për porosi

transferimi, ONE Albania do të përdorë CRN aktuale për të identifikuar qarkun.

### **3.2.2 Porosia PUI**

Nëse porosia ka të bëjë me një rrjet me soft dial tonë ose qarku është plotësisht i stabilizuar, ONE Albania do të caktojë një numër të ri PSTN ose adrese të re teknike të linjes si CRN, ndonëse nuk do të ofrohet asnjë shërbim PSTN.

### **3.2.3 Porosia PUS**

Në rast se kërkohet një linjë e re LLU, ONE Albania do të caktojë një numër të ri PSTN si CRN, ndonëse nuk do të ofrohet asnjë shërbim PSTN.

ONE Albania do të caktojë një numër të ri PSTN, për të shërbyer si Numër Referencë i Qarkut (CRN), tek rrjeti rezervë në varësi se kur bëhet e qartë që një rrjet rezervë është i disponueshëm dhe komunikon me kërkuesin e aksesit (AS) nëpërmjet Njoftimit për Përbushjen e Porosisë.

## **3.3 Ofrimi i të Dhënave të Linjës**

ONE Albania do të sigurojë informacion kërkuesit të aksesit (AS) duke kërkuar të Dhëna për Linjën nëpërmjet DRL (Linja e Kërkimit të Dhënave). Perpara se të dergohet një porosi DRL, AS duhet të marrë një CAF (Formular Autorizimi të Klientit) nga klienti fundor. Për detaje të plota të llojit të porosisë DRL, referohuni nëparagrafin 8.

## **3.4 Kushtet paraprake**

### **3.4.1 Autorizimi i Klientit**

Kur një ofrues shërbimi merr një porosi për të transferuar një shërbim ekzistues LLU tek ai, nga një ofrues tjetër shërbimi, kontrata ekzistuese me ofruesin humbës të shërbimit modifikohet.

Përderisa ofruesi përfitues i shërbimit nuk është një palë e kontratës origjinale ai duhet të marrë konfirmim me shkrim të pëlqimit të klientit për të modifikuar kontratën ekzistuese.

Një Formular i Autorizimit të Klientit standart (CAF) do të përdoret për këtë qëllim. CAF do të thotë formulari i plotësuar dhe i nënshkruar nga klienti, ose regjistrimi i Verifikimit të Palës së Tretë.

Porositë për linjat rezervë dhe qarqet me soft dial tonë nuk do të kërkojnë CAF përderisa nuk ekziston një marrëdhënie me klientin.

Proçesi CAF është paraqitur në dokumentat e mëposhtme:

1. Kërkesat për Formular CAF;
2. Kërkesat për Verifikimin e Palës së Tretë.

## **3.5 Shërbimet Konkurruese & Perjashtimet**

Kur një porosi LLU është marrë nga Kërkuesi i Aksesit për ofrimin e shërbimit LLU në një linjë, e cila ka një Shërbim Bitstream në shërbim ose në pritje, porosia LLU do të refuzohet duke pritur heqjen e shërbimit. Në mënyrë të ngjashme, kur porosia e një Bitstream është marrë nga një Kërkues i Aksesit për ofrimin e shërbimit në një linjë e cila ka porosinë e shërbimit LLU apo është në pritje, porosia do të refuzohet duke pritur heqjen e shërbimit LLU. Ky parim udhëzues do të lejojë Shitjen me Shumicë të ONE Albania që të menaxhojë ofrimin dhe Ndërprerjen e shërbimeve konkurruese. Sapo të jetë hequr shërbimi konkurrues, Kërkuesi i Aksesit mund të dërgojë një kërkesë të re porosie duke kërkuar ofrimin e shërbimit.

Për listën e plotë të përjashtimeve dhe shërbimeve konkurruese, referohuni në Shtojcën J.

Ka një numër skenarësh jashtë kontrollit të Kërkuesit të Aksesit që rezultojnë në shërbime konkurruese:

### 3.6 Fazat e Proçesit

Afatet e proçesit janë për SLA e LLU, SLA për Ofrimin & Riparimin e Aksesit te plote (ULMP) dhe Aksesit të Përbashkët (LS). Do te aplikohen fazat e mëposhtme:

Emri i Intervalit të Proçesit	Përshkrimi
Autorizimi Klientit	Kërkesa nga një klient që ti ofrohet shërbimi nga Kërkuesi i Aksesit
Dërgimi i porosisë	Dërgimi i porosisë LLU nga një Kërkuesi Aksesi
Miratimi	Gjatë proçesit të miratimit, Albtelecom aprovon porositë e dërguara nga Kërkuesi Aksesi për të siguruar që: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Porosia ka informacionin e mjaftueshëm për të mundësuar proçesimin e saj</li> <li>• Janë dhënë detajet korrekte</li> <li>• porosia pasqyron në mënyrë korrekte nevojat e Kërkuesit të Aksesit</li> <li>• Gjatë këtij proçesi Albtelecom do të: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kryejë miratimin e porosisë</li> <li>• Kryejë kategorizimin e linjës</li> <li>• Plotësimi i Proçesit të Miratimit çon në Pranimin ose Refuzimin e Porosisë</li> </ul> </li> </ul>
Pranimi porosisë	Kërkuesi i Aksesit do të marrë një njoftim Pranimi Porosie duke konfirmuar që porosia është pranuar dhe po proçesohet
Refuzimi Porosisë	Kur një porosi nuk merr Miratimin, Kërkuesi i Aksesit do të marrë një njoftim refuzimi
Porosia Dorëzuar me Sukses– Njoftimi i Plotësimit	Një Njoftim Finalizimi dërgohet tek Kërkuesi i Aksesit në pikën e kontaktit për përmbushjen me sukses të porosisë
Porosi e Pasukseshme - Njoftimi i Padorëzuar	Një Njoftim Mosdorëzimi i dërgohet Kërkuesit të Aksesit në pikën e kontaktit për dorëzimin e pasuksesshëm të porosisë në rast se porosia është anuluar.
Njoftimi i Humbjeve	Një njoftim humbesh i dërgohet Kërkuesit të Aksesit humbës për përmbushjen e porosisë

### 3.7 Afati i implementimit

Ky proçes parashikon se ONE Albania do te caktojë afatin e implementimit brenda datës së synuar. Aktualisht Kërkuesit e Aksesit nuk lejohen të specifikojnë datën e afatit të implementimit.

### 3.8 Pika e Terminimit e Rrjetit Lokal

Linja për shërbimin ULMP do të terminohet në Pikën e Terminimit të Rrjetit standart të ONE Albania (NTP) ose Njësinë e Terminimit të Rrjetit (NTU).

Për shërbimin e aksesit te perbashket, Rrjeti lokal do të terminohet në një NTU të përcaktuar në mënyrë specifike për shërbimin. Kjo do të ofrojë terminimet standarte të kabllimit PSTN si dhe terminime shtesë që janë lidhur me rrjetin lokal nëpërmjet një ndarësi (filter i frekuencave të larta).

### 3.9 Përgjegjësia për Instalimet Kabllore në Ambjentet e Klientit

Kërkuesi i Aksesit do të jetë përgjegjës për instalimin e çdo rrjeti kabllor të brendshëm që

nevojitet në ambjentet e klientit përtej ONE Albania NTU/NTP.

### **3.10 Porositë**

#### **3.10.1 Llojet e Porosive**

Bazuar në paragrafin 3.1.2 të mësipërm, llojet e porosive janë :

- 1 Porosia PU dhe PWU - Ofron ULMP në Linjën(at) e Punës
  - Konvertimi i LS në ULMP
  - Transferimi & dhe rifitimi i shitjes me pakicë të ONE Albania
- 2 Porosia PUI - Ofrimi i ULMP në Linjën(at) Insitu
- 3 Porosia PUS - Ofron ULMP në një Linjë të re ose Rezervë
- 4 Porosia PLS - Ofron Aksesin e Përbashkët të Linjës
- 6 PorosiaCU - Ndërprerja ULMP
- 5 Porosia CLS - Nderprerja e Aksesit të Përbashkët të Linjës
- 6 Porosia DRL - Kërkimi i të Dhënave për Linjë
- 7 Porosia CO - Anullimi i Porosisë
- 8 Porosia CHP - Ndryshimi i Portës së porosisë
- 9 Porosia ULE - Inspektimi i Linjës LLU
- 10 XLS - Transferimi i Aksesit te perbashket
- 11 - Anullo Porosinë

#### **3.11 Lloji i Porosive të Ofrimit**

Porosia e ofrimit është një porosi për ofrimin e një ose më shumë rasteve të Shërbimit LLU. Një porosi Ofrimi mund të përfshijë:

- 1 ofrimin e shërbimit ekzistues të ONE Albania për të ofruar aksesin e plote ULMP ose aksesin e perbashket (PU, PLS)
- 2 ofrimin e aksesit te plote ULMP duke përdorura nje linje plotësisht te stabilizuar (duke përfshirë linjat në on soft dial tonë (PUI)
- 3 ofrimin e shërbimit ULMP duke përdorur një linjë të re ose rezervë (PUS)

Porositë e llojit të ofrimit iniciohen nga Kërkuesi i Aksesit.

Porositë e Ofrimit dhe Ndërprerjes do të nevojiten gjithashtu kur një Kërkues Aksesit klient fundor ka ndërruar adresë dhe kërkon që ti ofrohet shërbimi LLU në adresën e re. Në rastin e Aksesit të Përbashkët të Linjës klienti duhet të këtë linjën e tij të re të instaluar përpara se të dërgohet kërkesa për aksesin e përbashkët të linjës.

#### **3.12 Porosia për ndërprerje**

Porosia për Ndërprerje është një porosi për Ndërprerjen e një ose me shume rasteve të Shërbimit LLU. Një porosi Ndërprerje mund të përfshijë:

- 1 Ndërprerjen e një shërbimi te aksesit të plote ULMP (CU)
- 2 Ndërprerjen e shërbimit Akses i Përbashkët në Linjë (CLS)
- 3 Çdo kombinim i mësipërm.

Llojet e porosive të Ndërprerjes janë të iniciuara nga Kërkuesi i Aksesit që aktualisht ka marrë me qera rrjetin lokal nga ONE Albania.

#### **3.13 Lloji i Porosisë “Transferim”**

- 1 transferimi i shërbimit ekzistues nga një ofruer shërbimi tek tjetri, duke përfshirë Shitjen me Pakicë të ONE Albania (PU dhe PWU).
- 2 transferimi i shërbimit Akses i Përbashkët Linjë nga një ofruer shërbimi tek tjetri

- në të njëjtën kohë duke e konvertuar atë në ULMP (PU).
- 3 transferimi i një shërbimi Akses i Përbashkët Linjë nga një ofrues shërbimi tek një ofrues tjetër shërbimi Akses të Përbashkët Linjë.

### **3.14 Lloji i Porosisë “Konvertim i aksesit te perbashket LS në akses te plote ULMP”**

Një porosi e Llojit konvertim, përdoret nga Kërkuesi i Aksesit për të informuar Shitjen me Shumicë të ONE Albania për të konvertuar Shërbimin e Aksesit të Përbashkët të Linjës tek ULMP (PU).

### **3.15 Lloji i Porosisë “Anullim”**

Një Porosi Anullimi është kërkesa nga Kërkuesi i Aksesit tek ONE Albania që të anullojë porosinë aktuale. Porosia e anulimit duhet të dërgohet përpara porosisë që kërkon pranimin e kërkesës së anulimit.

### **3.16 Lloji i Porosisë “Linja per kerkim te dhenash DRL”**

Porosia e Kërkesës DRL është një kërkesë nga Kërkuesi i Aksesit për Kategorizimin e Linjës në një linjë individuale (DRL).

### **3.17 Lloji i Porosisë “Ndryshim Porte”**

Porosia e Ndryshimit të Portës është një kërkesë për lëvizjen e klientit te tij ne ULMP ose LS tek MDF etij prane ambjenteve te ONE Albania

### **3.18 Lloji i Porosisë së “Inspektimit të Linjës LLU”**

Porosia ULE është një kërkesë për informacion te linjës.

## **4 Llojit i Porosisë Ofrim Shërbimi**

Lloji i porosisë së ofrimit do të ndjekë rrjedhën e procesit të paraqitur në Shtojcen A e përshkruar me detaje si më poshtë.

### **4.1 Parashikimi i një porosie ULMP (PU)**

Lloji i porosisë PU përfshin ofrimin e një linjë qe aktualisht i ofron shërbim përdoruesit fundor. Porositë PU kërkojnë vetëm që të kryhet puna e permutimit në MDF si dhe nuk përfshin vizitën në terren nga tekniku AP. Për çdo porosi PU mund të ofrohen deri në 5 linja nëse janë në të njëjten vendodhje. Kur zbulohet një paisje shumëfishuese në linjë dhe AS ka shënuar kutinë për këqyrje, ONE Albania do të kryejë një këqyrje Për të përcaktuar nëse porosia mundet të dorezohet apo jo nëpërmjet shkëmbimit me një kopje rezervë p.sh. heqja e MUX-it.

Kur zbulohet se abonenti është i lidhur në MUX në linjë dhe Kërkuesi i Aksesit nuk ka shënuar kutinë e kërkesës për inspektim, porosia do të refuzohet, arsyeja : "Nuk është kërkuar Linja për Bartje dhe këqyrja".

### **4.2 Ofrimi një Porosie Rrjeti në Vend (PUI)**

Lloji I porosisë PUI përfshin ofrimin e një linjë linjë qe është në vend në ambjentet e klientit fundor. Një linjë konsiderohet në vend në rast se është polotësisht e stabilizuar (duke përfshirë linjat në soft dial tone) në adresën e klientit. Porosia PUI kërkon vetem kryerjen e

punës së permutimit në MDF dhe nuk përfshin vizitën në stacion nga tekniku AP. Deri në 5 linja për porosinë PUI mund të ofrohen nëse ato janë në të njëjtën vendodhje. Për të lehtësuar Kërkuesin e Aksesit në vendosjen e llojit të porosisë PUI, Shitja me Shumicë e ONE Albania i ka siguruar OAO akses për Kërkimin e Adresës. Në terma të thjeshtë të dhënat për këtë kërkim do të jenë një adresë e plotë/e pjesëshme ose një numër telefoni i mëparshëm dhe rezultati do të jetë një identifikues unik (ARD ID) për adresën specifike.

#### **4.3 Ofrimi i Linjës së Re ose porosia linjë Rezerve (PUS)**

Lloji i porosisë PUS përfshin veçimin e një linjë të re ose linjës rezervë që nuk i ofron shërbim klientit fundor. Porositë PUS kërkojnë kryerjen e punës së permutimit në MDF dhe përfshin gjithashtu punime në kabinetet e jashtme nga tekniku AP. Mund të ofrohen deri në 5 linja për porosi PUS nëse janë në të njëjtën adresë.

ONE Albania do të kryejë një studim për të përcaktuar nëse një çift rezervë është i disponueshëm. Kjo do të kryhet në lidhje me ofrimin e porosisë dhe mund të përfshijë:

1. bërjen e lidhjeve në pikat e lidhjeve të kryqezimit dhe pikat e shpërndarjes sipas kërkesës
2. plotësimi i një linjë fizike të vecantë single span drop wire
3. shkëputja e çiftit brenda adresës së klientit në NTU ose NTP sipas rastit

Në rast se ONE Albania nuk ka mundësi që të sigurojë një çift rezervë ose të ofrojë një linjë të re, Kërkuesi Aksesit do të njoftohet nëpërmjet një "Njoftim për Mosofrim", me arsien e duhur.

#### **4.4 Ofrimi i porosisë se Aksesit të Përbashkët (PLS)**

Porosia PLS përfshin aksesin e përbashkët në linjë e cila i ofron aktualisht shërbim klientit fundor. Shërbimi i Linjës së Përbashkët është i integruar mbi të njëjtën linjë metalike dyfishe si shërbimi voice, shitja me pakicë e PSTN të ONE Albania. CPS nuk ndikohet nga shërbimi i linjës të përbashkët. Porositë PLS kërkojnë vetëm që të kryhet puna permutimit në MDF dhe nuk përfshin vizitën në terren nga tekniku AP. Për porosinë PLS mund të sigurohen deri në 4 linja nëse ato janë për të njëjten llogari.

#### **4.5 Dërgimi i Porosisë**

Kërkuesit e Aksesit do të dërgojnë Porositë nëpërmjet e-mailit:

Për të dërguar porosinë, AS do të:

- a. plotësoje porosinë tip me informacionin e nevojshëm
- b. sigurojë të paktën 2 numra kontakti për klientin sipas nevojës (të paktën një numër kontakti është i detyrueshëm për Porositë PUS).

#### **4.6 Aprovimi i Porosisë**

##### **4.6.1 Përkufizimi**

Për Porositë PU, PLS, PUS kërkohet miratimi manual.

##### **4.6.1.1 Ofrimi i ULMP (PU), Ofrimin i Aksesit në Linjë (PLS) dhe Transferimi i Aksesit në Linjë (XLS)**

Me marrjen e porosisë LLU, AP do të kryejë një sërë hapash vlerësimi për të përcaktuar



nëse mund të ofohet shërbimi i kërkuar. Këto hapa janë përshkruar në seksionet e mëposhtme. Rezultati i këtij procesi do të jetë refuzim i porosisë (p.sh. "Njoftim Refuzim Porosie) ose pranim formal i porosisë (p.sh. "Njoftim Pranim Porosie").

#### **4.6.1.2 Ofrimi i ULMP në një Linjë Insitu (PUI)**

Me marrjen e porosisë LLU, AP do të kryejë një numër kontrollesh vlerësimi për të përcaktuar nëse shërbimi i kërkuar mund të ofrohet ose porosia PUI do të vendoset në manualin e rrjedhës së punës për vlerësim. Këto hapa janë përshkruar në paragrafet e mëposhtme. Rezultati i procesit do të jetë ose refuzimi i porosisë (p.sh. "Njoftim Refuzimi Porosie" ose pranim formal i porosisë (p.sh. "Njoftim Pranimi Porosie").

#### **4.6.1.3 Ofrimi i ULMP në një Linjë të Re apo Rezervë (PUS)**

Me marrjen e porosisë LLU, AP do të vendosë porosinë PUS në manualin e rrjedhës së punës për vlerësim. ONE Albania do të kryese një sere kontrollesh për të të përcaktuar nëse mund të ofrohet shërbimi. Këto hapa janë përshkruar në paragrafet e mëposhtme. Rezultati i procesit do të jetë ose refuzimi i porosisë (p.sh. "Njoftim Refuzimi Porosie" ose pranim formal i porosisë (p.sh. "Njoftim Pranimi Porosie)

### **4.6.2 Kontrolllet e Vlerësimit të Porosisë**

#### **4.6.2.1 Kontrolli i Shërbimit Aktual PU, PLS & XLS**

AP do të kryejë disa hapa vlerësimi për të përcaktuar nëse do të pranojë apo refuzojë porosinë. Më poshtë është dhënë një shembull i këtyre kontrolleve. Një listë e plotë jepet në Kontratën e Të Dhënave.

1. AP do të kontrollojë nëse porosia është plotësuar në mënyrë korrekte
2. nëse përputhet numri i telefonit dhe llogarisë
3. nuk ka asnjë porosi ofrimi të papërfunduar (në pritje) për linjë(a)
4. llogaria e klientit është aktive
5. Llogaria kryesore është e vlefshme
6. llojet e linjës/ave përputhen me të dhënat (PSTN/ISDN)
7. linja(t) në verifikim
8. asnjë nga shërbimet e përjashtuara nuk është aktualisht në përdorim në rrjetin lokal.

Shënim: Për porositë shumë linjëshe nëse një linjë nuk aprovohet, atëherë e tërë porosia do të refuzohet.

#### **4.6.2.2 Kontrolli i Shërbimit Aktual PUI**

AP do të kryejë vlerësimin në PUI dhe dërgon njoftimin pranim / refuzim tek AS.

AP do të kontrollojë:

1. Llogaria Kryesore është e vlefshme
2. Shkëmbimi është korrekt

#### **4.6.2.3 Kontrolli i Shërbimit Aktual PUS**

AP kryen vlerësimin në PUS dhe dërgon njoftimin pranim / refuzim tek AS. Ky njoftim do të përfshijë arsyen e refuzimit. Në rast se porosia refuzohet, AS fitues duhet të ridërgojë porosinë, ora rifillon në Ditën 0 (refuzim = përfundim procesi).

AP do të kontrollojë nëse:

1. Llogaria Kryesore është e vlefshme
2. Shkëmbimi është korrekt

AP kontrollon manualisht nëse adresa e dërguar në porosi përputhet me adresën e bashkangjitur në OSS-në e AP. Në rast se adresa nuk përputhet, porosia refuzohet, arsyetimi: "mospërputhje adrese".

#### **4.6.3 Testimi i Linjës dhe Kategorizimi i Linjës**

Si pjesë e procesit të Vlerësimit, AP do të kryejë një test të linjës standartë që rrjeti lokal përshatet me parametrat elektrik për ULMP dhe shërbimet e Aksesit të Rrjetit siç është përcaktuar në Planin e Shërbimit 102 dhe 103 të ARO të ONE Albania.

ONE Albania do të perdore testin e linjës, kabllin e saj dhe të Dhënat e klientit Për të kontrolluar nëse paisjet shumëfishuese ose matësi privat i pajtimtarit është në përdorim.

Në rast se porosia ka të bëjë me linjën ekzistuese PSTN të ONE Albania, atëherë AP do të ketë mundësi të kryejë testimin e linjës me paisjen e tij të testimit të linjës përdersia linja është permutuar në paisjen e ONE Albania.

Në rast se ofrohet një kopje rezervë ose përdoret një kopje me soft dial tone, teknikët e ONE Albania do të kryejnë testimin manual të linjës gjatë përgatitjes së linjës.

Testimi i Linjës do të përllogarisë gjithashtu Kategorizimin e Linjës (bazuar në kapacitetet e matjes së tokës) dhe distancën. Shiko Paragrafin 8.

#### **4.6.4 Nevoja e Inspektimit**

Në rast se kontrollet e vlerësimit tregojnë që paisja multiplex është në përdorim, do të kërkojë një inspektim dhe atëherë ONE Albania do të refuzojë porosinë.

#### **4.6.5 Linja me CPS**

Një porosi për ULMP për një linjë me CPS do të refuzohet. Një porosi për Aksesin e Përbashkët nuk ka efekt në CPS.

#### **4.6.6 Përgjigja e Vlerësimit**

Pas përfundimit të kontroleve, AP ose do të refuzojë porosinë ose do ta pranojë atë tek AS duke treguar nëse shërbimi mund/nuk mund të ofrohet

#### **4.6.7 Porosia e Pranuar**

Në rast se porosia është pranuar ose është pranuar porosia për të kqyre për linjë rezervë, ONE Albania do të njoftojë Kërkuuesin e Aksesit që porosia është pranuar.

#### **4.6.8 Porosia e Refuzuar**

Në rast se porosia është refuzuar, AP do të lëshojë Kërkuesi i Aksesit një Njoftim Refuzimi Porosie që do të përfshijë arsyen për refuzim.

### **4.7 Përgatitja e Linjës**

Pas vlerësimit të porosisë, ONE Albania do të planifikojë dhe ekzekutojë çdo punë që kërkohet për të përgatitur linjen lokale për shërbimin e porositorit.

Aktivitetet e mëposhtme do të ndërmerren sipas nevojës.

#### **4.7.1 Riparimi i Kabllit**

Në rast se rrjeti lokal nuk e kalon Testin e Linjës atëherë ONE Albania do të beje përpjekjet e mundshme për të rregulluar problemin si dhe ta sjelle rrjetin në standartet sipas percaktimit në ARO.

Në rast se rrjeti lokal nuk mund të riparohet, ONE Albania do të përdorë Njoftimin e Mosofrimit për të njoftuar Kërkuesin e Aksesit që shërbimi i kërkuar nuk mund të ofrohet si dhe arsyet për deshtimin.

#### **4.7.2 Instalimi i NTUs**

##### **4.7.3 Aksesit i përbashkët në Linjë (PLS)**

Ana e klientit e Njesisë së terminimit në Rrjetin e ONE Albania (NTU) është pika e finale e përgjegjësisë së ONE Albania për produktin e Aksesit të Klientit. Në ambientet e klienteve, Kërkuesi i Aksesit do të aksesojë në Linjën e Përbashkët, nëpërmjet Njesisë së Terminimit të Rrjetit të ONE Albania (NTU). Nëse NTU ose paisja splitter duhet të pershtatet, ONE Albania do të pajisë AS me NTU e nevojshme dhe/ose splitterin përkatës. AS do të jetë përgjegjëse për instalimin dhe testimin e NTU sipas parametrave të instalimit të rëna dakord.

Ofrimi dhe mirëmbajtja e rrjetit kabllor të klientit përtej NTU për shërbimin ADSL si dhe ofrimi dhe instalimi i çdo paisje për ti ofruar klientit shërbimet pike me pike të shërbimit ADSL do të jetë përgjegjësi e AS. Zëvendësimi ose ndryshimet tek sistemi kabllor ekzistues i klientit për të instaluar paisjen e duhur do të jenë gjithashtu përgjegjësi e AS.

Ofrimit NTU dhe procesi i levrimit jepet më poshtë:

1. AS dergon me e-mail formularin e plotësuar të porosisë NTU (Shtojca H) menaxherit të Produktit ULMP/LS të ONE Albania, i cili organizon dorëzimin e porosisë
2. AS do të porosisë NTU / Splitera mbi baze mujore duke i dërguar të kombinuar menaxhimin e inventarit / formularin e porosisë në Shtojcen H, Shitjes me Shumicë të ONE Albania.
3. AS nukdo të aktivizojë shërbimin mbi linjë përpara se splitteri të jetë pershtatur

##### **4.7.3.1 Shërbimi ULMP (PU, PUI &PUS)**

Në ambientet e klientëve, AS do të aksesojë Rrjetin lokal metalik (ULMP) nëpërmjet Njesisë së Terminimit të Rrjetit standart të ONE Albania (NTU), ose Piken e Terminimit të Rrjetit (NTP), nëse nuk ka NTU. Kur mund të këtë nevojë të instalohet paisja NTU, kur nuk ekziston asnjë pike demarkacioni i identifikueshem, ONE Albania do ta pajisë AS me një Njësi Terminimi Rrjeti të standartizuar (NTU) nëpërmjet marrëveshjes, që të instalohet dhe testohet nga AS sipas standarteve të miratuara për instalimin.

Ofrimi, instalimi, zëvendësimi, dhe mirëmbajtja e çdo paisje/lidhje shtesë në anën e klientit të ONE Albania NTU/NTP që nevojitet për ti ofruar përdoruesit fundor shërbimet e AS do të jetë përgjegjësi e AS.

Proçesi për ofrimin dhe aksesin do të jetë i njëjtë si ai për Aksesin e përbashkët.

#### **4.8 Lidhja (Jumpering)**

Para ose në datën e fillimit të shërbimit, ONE Albania do të lidhë (jumper) linjen në MDF e ONE Albania.

## 4.9 Proçesi i percaktimit për Porositë PUS

Proçesi i porosisë PUS do ti mundesoje AP te caktoje nje afati kohor jo me pak se 7 dite.

Gjatë vizitës në vend, tekniku AP do të qartesojë që puna është kryer në emër të AS sipas skriptit të aprovuar; “Jam duke telefonuar në emer të (AS) që të ofroj shërbimin

Kur AP nuk mund të zbatojë kohën e rënë dakord për takim, klienti do të kontaktohet perpara orarit të takimit dhe do të caktohet një takim i ri.

Në rast se klienti është kontaktuar paraprakisht për takimin nga tekniku, dhe e njofton teknikun qe nuk mund të zbatojë takimin. Tekniku do ta ktheje porosinë tek AS. Kërkuesi Aksesit do të mare “Njoftimin e Mosofrimit” nga AP, me arsyen "klienti i padisponueshem ". Kur klienti nuk paraqitet në takimin e rënë dakord, tekniku AP në vend do të perpiqet që të kontaktojë klientin në numrin e kontaktit. Në rast se klienti nuk mund të kontaktohet, tekniku do të lere një shenim duke informuar klientin që të kontaktoje AS-ne. AP do të ktheje porosinë tek AS. Kërkuesi Aksesit do të mare një “Njoftim Mosofrimi” nga AP me arsyetimin “klient i padisponueshem”.

AP do tia referojë çështjen AS-se ku (i) Dorëzimi i Shërbimit ONE Albania nuk mund të kontaktojë klientin ose (ii) klienti nuk deshiron shërbimin ose nuk bie dakord që të caktoje një takim, ose (iii) AP deshton qe të realizojë takimin e rënë dakord si dhe nuk mund të arrihet një alternativë

- a. AS do të këtë 5 ditë punë për të organizuar takimin
- b. Çdo takim duhet të behet të pakten pas 10 ditëve punë nga data në të cilen është rënë dakord me klientin për takimin e ri.
- c. AS duhet të informojë AP-në për orën e takimit të ri brenda 24 orëve nga organizimi i takimit.
- d. Në rast se pas 5 ditëve punë, AS nuk riorganizon një takim, atëherë AP do të anulroje porosinë. Kërkuesi Aksesit do të mare “Njoftim Mosofrimi” nga AP. Porosia do te jete mbyllur (p.sh. anuluar) në sistemet AP, me shpjegimin “klienti i padisponueshem”.
- e. Pikat e kontaktit për caktimin e takimeve të klientit janë si me poshtë:
  - I AP – Menaxhimi i Porosisë se Shumices (email + detajet e telefonit për dy kontakte)
  - II AS – Departamenti i Proçesimit të Porosisë (email + detajet e telefonit për dy kontakte)

### 4.9.1 Proçesi Manual I Kontaktit të Klientit

Një vizitë kërkohet në kushtet e meposhtme: Ju lutem referohuni paragrafit 4.2 të mesiperm. Në rastin kur kërkohet vizita e klientit në vend, hapat e meposhtëm do të ndiqen:

1. Sapo të jetë pranuar porosia dhe mendohet që nevojitet vizita e klientit në vend, Shpërndarja e Shërbimit të ONE Albania do të kontaktojë klientin dhe perpiqet që të bien dakord për një takim.
2. Kontaktimi i klientit :
  - a. AP do të bëjë të pakten 3 perpjekje brenda një periudhe dy ditore për të kontaktuar klientin.
  - b. Thirrjet do të behen gjatë orarit normal të punës.
  - c. Numri i përdoruri kontaktit do të jetë numri(at) të përfshirë nga AS në “detajet e kontaktit të klientit. Shënim: Preferohet numër celulari.
  - d. Një mesazh zanor do të lihet në çdo thirrje, ku zeri është i disponueshëm.
  - e. Skriptimi i aprovuar për thirrjet e para dhe të dyta do të jenë si me poshtë:

“Miremengjes/mirëdita – ky është Shërbimi i Shpërndarjes i ONE Albania. Jemi perpjekur që t’ju kontaktojmë Për të lenë një takim për vizitë në vend që t’ju ofrojmë shërbimin në (Emri i Kërkuesit të Aksesit) – por fatkeqesisht nuk mundëm t’ju kontaktonim. Do t’ju telefonojmë shume shpejt perseri”

- f. Skriptimi i miratuar për thirrjen e tretë dhe të fundit do të jetë si me poshtë vijon “Miremengjes/mirëdita – ky është Shërbimi i Shpërndarjes të ONE Albania. Jemi perpjekur që t’ju kontaktojmë Për të lenë një takim për vizitë në vend që t’ju ofrojmë shërbimin në (Emri i Kërkuesit të Aksesit) – por fatkeqesisht e kishim të pamundur që t’ju kontaktonim. Ju lutem kontaktoni (Emri i AS) sa më shpejt që të jetë e mundur Për të planifikuar një vizitë për teknikun tone– Faleminderit”. Referohu Hapit 6.
3. Organizimi i një takimi – Gjatë bisedës me klientin AP do të ndjeke një skriptim të aprovuar dhe caktohet një takim me klientin.
- a. Skriptimi i aprovuar do të jetë si me poshtë vijon “Miremengjes/mirëdita - ky është Shërbimi i Shpërndarjes i ONE Albania. Po ju telefonojmë për të lenë një takim për vizitë në vend që t’ju ofrojmë shërbimin në (Emrin e Kërkuesit të Aksesit)”
  - b. Kur takimi është konfirmuar ndërmjet AP dhe klientit. AP do të rishikojë punët e brendshme Për të pasqyruar datën e takimit.
  - c. Kur klienti dëshiron të aprovoje një periudhë të caktuar takimi, jashtë afatit të paracaktuar për plotësimin e SLA, kjo do të rregullohet brenda orarit standart të punës. AP do të rishikojë porosinë për të pasqyruar datën e re dhe afati i SLA do të shtyhet për rregullimin e këtij ndryshimi.
  - d. Në rast se klienti nuk dëshiron shërbimin ose nuk bie dakord të caktojë një takim, AP do të informojë AS-në që të kontaktojë klientin dhe të perpiqet që të lere një takim.

#### **4.10 Proçesi i Identifikimit të Linjës në ambjentet e klientit**

Kur një linjë është dorezuar sipas kornizës së shpërndarjes në ambjentet e klientit, tekniku i AP-se do të ndjekë (tag) linjën e ofruar.

#### **4.11 Plotësimi**

Kur ONE Albania të ketë përmbushur shërbimet e tij, njofton AS-në sipas afatit maksimal të ofrimit të SLA standard. Normalisht, proçesi i Vlerësimit do të identifikojë të gjitha arsyet pse një porosi nuk mund të përmbushet. Megjithatë, është e mundur që disa ose të gjitha shërbimet e porositura nuk mund të ofrohen pas kryejës se vlerësimit. Kështu që ka tre situata të mundshme.

#### **4.12 Porosia e Plotësuar me Sukses**

Të gjitha shërbimet e porositura u ofruan me sukses.

Në këtë rast, Kërkuesi Aksesit do të marrë një “Njoftim Përfundim” nga AP sapo porosia të perfundoje në sistemet e ONE Albania.

Detajet e lidhjes do të jenë të disponueshme në Njoftimet e Përfundimit të AP për Porositë LLU (PU, PUI, PUG, PUS, PLB, PLS, CHP, XLS).

##### **4.12.1 Mosofrimi**

Porosia nuk është ofruar me sukses.

Në kere rast, Kërkuesi Aksesit do të marrë një “Njoftim Mosofrimi” me shpjegimin e duhur nëpërmjet AP sapo porosia të jetë mbyllur (p.sh. anuluar) në sistemet e ONE Albania. Për një listë të arsyeve të mosofrimit shiko Shtojcën I.

#### **4.13 Njoftimi i humbjes**

Në përfundim të një urdhëri, ONE Albania do të dërgojë një Njoftim Humbjeje tek ofruesi(t) i shërbimit që humbet klientin nëpërmjet AP.

Në rastin kur të dy, si ULMP & LS ofrojnë porosi, kjo do të konsistojë në dërgimin e njoftimit të humbjes tek operatori i humbjes së klientit (nëpërmjet njoftimit me email) duke e njoftuar operatorin që ata kanë humbur shërbim.

### **5 Ndërprerja e llojit të porosisë**

Ekzistojnë dy lloje ndërprerjeje të porosisë: Ndërprerja e ULMP (CU) dhe Ndërprerja e Ndarjes së Linjës (CLS). Llojet e ndërprerjes do të ndjekin afatin kohor të përcaktuar për sigurimin e shërbimit.

ONE Albania nuk do të kryejë inspektime për të hequr NTU-të, por do të heqë lidhjen MDF (jumping) nga pajisja e terminimit të AS.

Kërkuesit e Aksesit nuk mund të rilidhin pajisjet e tyre deri në marrjen e njoftimit të përfundimit nëpërmjet AP.

#### **5.1 Paraqitja porosisë**

Kërkuesit e aksesit do t'i dërgojnë porositë e tyre AP. Për dërgimin e porosisë, Kërkuesi i Aksesit duhet:

- Të plotësojë formularin e porosisë për AP me të gjithë informacionin e kërkuar;

#### **5.2 Vlefshmeria e porosisë**

AP do të zbatojë të gjitha hapat e vlefshme për të përcaktuar nëse porosia duhet të pranohet / refuzohet. Shembulli i mëposhtëm paraqet këto kontrolle. Lista e plotë është e përfshirë në të dhënat e Kontratës.

AP do të kontrollojë nëse:

- Porosia është përmbushur në mënyrë korrekte;
- Telefoni dhe numri i llogarisë përputhen;
- Llogaria është aktive.

#### **5.3 Pranimi / Refuzimi i porosisë**

Nëse porosia pranohet, ONE Albania do të njoftojë Kërkuesin e Aksesit se porosia është pranuar.

Nëse porosia është refuzuar, AP do t'i lëshojë Kërkuesit të Aksesit një Njoftim për Refuzimin e Porosisë të arsyetuar.

#### **5.4 Përfundimi i porosisë**

Linja ishte ndërprerë me sukses.

Në këtë rast, Kërkuesi i Aksesit do të marrë një "Njoftim Përfundimi" nëpërmjet AP kur porosia përfundon në sistemet e ONE Albania.

#### **5.5 E padërgueshme**

Porosia për ndërprerje nuk është dërguar me sukses.

Është e mundur që në disa raste tekniku i telave lidhës të mos gjejë asnjë tel në çiftin e caktuar në pajisjen e terminimit të AS. Nëse tekniku has një problem të tillë, ai do të

kontaktojë kontrolluesin/ zyrën e tij, i cili nga ana e tij duhet të kontaktojë AS për të konfirmuar rrugëzimin. Tekniku do të presë 30 minuta për një përgjigje. Nëse nuk është marrë një përgjigje deri në momentin e largimit të teknikut, ONE Albania nuk do ta ndërpresë qarkun. Në këtë rast, Kërkuesi i Aksesit do të marrë njoftimin “E padërgueshme “ të arsyetuar, menjëherë kur porosia të jetë mbyllur (p.sh anuluar) nga sistemet e ONE Albania.

## **6 Anullimi i llojit të porosisë**

Nëse bëhet e nevojshme për një AS të anulohet një porosi që nuk është pranuar ende, AS do të lëshojë një porosi anulimi ( CO) për AP.

Anullimet e pjeshme të porosive nuk lejohen.

Megjithatë, nëse porosia është pranuar, por nuk është përfunduar ende, atëherë anulimi duhet të bëhet nëpërmjet email duke përdorur formularin për porosinë LLU. Proçesi është përshkruar në Aneksin B.

### **6.1 Dritarja e anulimit**

Kërkuesve të Aksesit u lejohet të anulohet porositë e tyre deri në momentin kur këto porosi nuk janë pranuar. Nëse një porosi është pranuar, nuk mund të bëhen anulimet.

Pas kësaj, kërkesat për anulime do të refuzohen, dhe AS-së do t'i kërkohej të dërgojë një porosi ndërprerjeje.

### **6.2 Dorëzimi i porosisë**

Nëse bëhet e nevojshme për Kërkuesin e Aksesit të anulohet një porosi që nuk është pranuar ende, AS do të lëshojë një porosi anulimi (CO) kundër porosisë së ofrimit ose ndërprerjes.

### **6.3 7.3 Miratimi/Anulimi i porosisë**

Nëse porosia është pranuar, atëherë Kërkuesi i Aksesit do të marrë një “Njoftim refuzimi” duke e këshilluar se kërkesa e porosisë është refuzuar meqënëse porosia origjinale është pranuar.

Nëse porosia e CO është refuzuar, por porosia nuk ka përfunduar ende, atëherë AS do t'i duhet të lëshojë një porosi për llojin e ndërprerjes për të udhëzuar ONE Albania-in për të ndërprerë shërbimin.

## **7 Lloji i porosisë së konvertimit të LS në ULMP**

Një lloj porosie konvertimi do të përdoret kur:

1. AS ekzistuese dëshiron të konvertojë shërbimin e tij ekzistues të LS në ULMP. Supozohet se AS ka marrë CAF e duhur nga klienti. Kjo lloj porosie do të përdoret vetëm kur AS do një shërbim ULMP dhe jo kur klienti ka treguar AS se dëshiron të ndërpresë shërbimin PSTN të ONE Albania. Në këtë rast klienti duhet të kontaktojë ONE Albania për t'i kërkuar ndërprerjen e linjës së PSTN-së.

### **7.1 Para-sigurimi I pajisjes se aksesit**

Është rënë dakord, AS duhet të ketë pajisje aksesi pa splitera të terminuara në MDF për përgatitjen e porosive të këtij lloji. Kjo do të lejojë që konvertimi të vazhdojë menjëherë dhe që ky konvertim të realizohet nga ri-lidhja dhe jo nga vizita e AS për konfigurimin e pajisjes së tij.

ONE Albania nuk do të pranojë porosi që nuk kanë informacionin përkatës të terminimit të MDF.

### **7.2 Paraqitja e porosisë**

Kërkuesit e Aksesit do të dërgojnë porositë tek AP.

Për dërgimin e porosisë, Kërkuesi i Aksesit duhet të:

- Të plotësojë formularin e porosisë me të gjithë informacionin e kërkuar,
- Të sigurojë që block and pins të LS aktuale janë të përfshira në porosi,
- Të dërgojë porosinë me email tek AP

### **7.3 Miratimi i porosisë**

AP do të zbatojë të gjitha hapat e vlefshme për të përcaktuar nëse porosia duhet të pranohet / refuzohet. Shembulli i mëposhtëm paraqet këto kontrolle. Lista e plotë është e përfshirë në të dhënat e Kontratës.

AP do të kontrollojë nëse:

- Porosia është përmbushur në mënyrë korrekte;
- Telefoni dhe numri i llogarisë përputhen;
- Llogaria është aktive;
- Linja telefonike aktualisht ka një shërbim LS;
- Block and pins të LS janë përfshirë në porosi.

Kur ONE Albania njofton një AS, për të konvertuar një shërbim të LS në ULMP, AS nuk mund të refuzojë kërkesën, por duhet të përgjigjet:

1. duke dërguar konvertimin dhe mbajtjen e pajisjes së njëjtë të aksesit, ose
2. duke dërguar konvertimin dhe caktimin e terminimeve të new block and pin (pa splitter), ose
3. duke dërguar një porosi ndërprerjeje të LS (CLS).

AS do t'i jepen 10 ditë pune kohë për të vendosur për përgjigjen– duke i dhënë kohën e mjaftueshme për të kontaktuar klientin para se të kthejë përgjigjen.

Nëse brenda 10 ditëve pune nuk është marrë asnjë përgjigje, të gjitha shërbimet për rrugëzim(et) do të ndërpriten nga ONE Albania. AS do të marrë një Njoftim Humbjeje duke e informuar atë për ndërprerjen.

AS do të jetë përgjegjëse për koston e ndërprerjes së linjës së shërbimit LS.

### **7.4 Pranimi i porosisë**

Nëse porosia është pranuar, ONE Albania do të njoftojë kërkuesin e Aksesit që porosia është pranuar.

#### **7.4.1 Ndërprerja e qarkut**

Nëse AS dëshiron të ndërpresë LS në qark duhet të:

- dërgojë porosinë e ndërprerjes (CLS) tek AP



## **7.5 Refuzimi i porosisë**

Nëse porosia është refuzuar, AP do t'i lëshojë Kërkuesit të Aksesit një Njoftim Refuzimi të Porosisë ku do të përfshihen dhe arsyet e refuzimit.

## **7.6 NTU**

Referohuni në seksionit 4.3.2 Instalimi i NTU-ve.

## **7.7 Lidhje (Jumpering)**

Gjatë ose para arritjes së objektivit për datën e shërbimit, ONE Albania do të lidhë linjen në MDFe tij. Ekzistojnë dy raste të mundshme siç janë përshkruar më poshtë:

### **7.7.1 Detajet e block and pin**

ONE Albania do të lidhet në detajet e block and pin të deklaruara në porosi.

Nëse AS i kërkon ONE Albania-it të përdorë detajet e block and pin, të cilat aktualisht përdoren për LS, ai duhet t'i caktojë ato në porosi. Në të kundert ai duhet të caktojë detaje për new block and pin.

Nëse new block and pin janë përdorur, tekniku do të ndjeke procesin standart të PU

## **7.8 Përfundimi**

Kur ONE Albania të ketë përfunduar të gjitha aktivitetet e tij do të njoftojë AS. Normalisht, procesi i miratimit do të identifikojë çdo arsye të mos-sigurimit të porosisë. Megjithatë, është e mundur që një arsye mund të identifikohet pas Pranimit të Porosisë dhe para përfundimit.

### **7.8.1 Porosia e përfunduar me sukses**

Të gjitha shërbimet e porositura u kryen me sukses.

Në këtë rast, Kërkuesi i Aksesit do të marrë një "Njoftim Përfundimi" sapo porosia të përfundojë në sistemet e ONE Albania.

### **7.8.2 E padërgueshme**

Porosia nuk është kryer me sukses.

Në këtë rast, Kërkuesi i Aksesit do të marrë Njoftimin "E padërgueshme" me arsyen e saktë, nga AP menjëherë sapo porosia të jetë mbyllur (p.sh anuluar) në sistemet e ONE Albania. Për listën e arsyeve të padërgueshmërisë shikoni Aneksin I.

## **8 Lloji I porosise për Linjën e Kërkimit të të Dhënave**

Porosia e Linjës së Kërkimit të të dhënave (DRL) është përdorur për të siguruar Kategorizimin Linjës për linjën individuale. Detajet e kthyer janë:

- 1 Kategorizimi – Gjatësia e linjës – e shkurtër, mesatare, e gjatë
- 2 Kapaciteti –Kapaciteti A deri në B i linjës i shprehur ne microFarads
- 3 Linja – percjelles bakris
- 4 Lloji i testit të linjës – Sistemi i testit te linjës (LTS)
- 5 Vend-ndodhja e Centralit – Centrali nga origjinohet rrjeti
- 6 Lloji i sigurimit - Kjo fushë është gjithmonë bosh.
- 7 Sub-Frame – Vendndodhja e Sub-frame në MDF ku përfundon linja e klientit

### 8.1 Paraqitja e porosisë

Kërkuesit e Aksesit do t'i dërgojnë porositë tek AP. Për dërgimin e porosisë, Kërkuesi i Aksesit duhet:

1. të plotësojë formularin për pororsinë me të gjithë informacionin e kërkuar
2. të dergojë porosinë me email tek AP

### 8.2 Kategorizimi i linjës

Porosia DRL do të njoftoje mbi kategorizimin e linjës individuale. Rezultati mund të jetë i shkurtër, mesatar ose i gjatë, bazuar në tabelën e mëposhtme.

Grupi i ekspertëve të CLFMP ka vendosur që përcaktimet e secilës kategori të jenë sipas tabelës së mëposhtme:

Kategoria	Shuarja @ 300 kHz	Distanca
Ultra e shkurtër	< 11.5 dB	< 0.6 km
Ekstra e shkurtër	< 21 dB	< 1.2 km
E shkurtër	□ 21 and < 38 dB	< 2.1 km
Mesatare	□ 38 and < 42 dB	2.1 km – 2.3 km
E gjatë	□ 42 dB	> 2.3 km

### 8.3 Dërgimi I të dhënave shtesë

Ju lutem shihni seksionin 3.3.

## 9 Transfera e AS dhe procesi i kthimit të fitimit me pakicë të ONE Albania

Porositë për transferat dhe kthimin e fitimit do të ndjekin rrjedhën e procesit të treguar në Ankesin A dhe të përshkruar më poshtë.

### 9.1 Sigurimi I porosisë së transferimit të ULMP

Porosia për transferimin e PU ose për kthimin e fitimit PWU përfshin hapjen e një linje që aktualisht u siguron përdoruesve fundorë shërbimin ULMP. Mund të sigurohen deri në 5 linja për çdo porosi PU, nëse ato janë në të njëjtën llogari.

Porosia e transferimit do të përdoret për të transferuar shërbimin ULMP nga një operator LLU tek tjetri.

Lloji i porosisë për kthimin e fitimit do të përdoret nga ONE Albania për të transferuar një klient nga ULMP tek Shitja me Pakicë e PSTN.

### 9.2 Sigurimi i transferimit të porosisë së LS

Lloji i porosisë XLS përfshin transferimin e shërbimit të Ndarjes së Linjës nga një operator LLU tek një tjetër.

Porositë XLS mund të transferojnë vetëm linja teke në një porosi.

### **9.3 Paraqitja e porosisë**

Kërkuesit e aksesit do të dërgojnë porositë tek AP. Për të dërguar porosinë AS duhet të plotësojë formularin për porosinë AP me të gjithë informacionin e kërkuar

- të dergojë porosinë në AP nëpërmjet emailit.
- 

### **9.4 Vlefshmeria e porosisë**

AP do të zbatojë të gjitha hapat e vlefshme për të përcaktuar nëse porosia duhet të pranohet/refuzohet. Shembulli i mëposhtëm paraqet këto kontrolle. Lista e plotë gjendet në të dhënat e Kontratës.

AP do të kontrollojë:

- që porosia është përmbushur në mënyrë korrekte,
- që klienti është aktualisht klient i ULMP,
- që UAN është korrekt.

Ju lutem vini re: Për porositë shumë-linjëshe nëse një linjë dështon do të refuzohet miratimi i të gjithë porosisë.

#### **9.4.1 Përgjigjja e miratimit**

Pas përfundimit të kontrolleve, AP do të refuzojë ose pranojë porosinë e AS duke treguar se shërbimi mund/nuk mund të sigurohet.

#### **9.4.2 Pranimi i porosisë**

Nëse porosia është pranuar, ONE Albania do të njoftojë Kërkuesin e Aksesit që porosia është pranuar.

#### **9.4.3 Refuzimi i porosisë**

Nëse porosia është refuzuar, AP do të lëshojë kërkuesit të Aksesit një Njoftim Refuzimi të Porosisë të arsyetuar.

Nëse arsyet për mos ofrimin e shërbimit janë më tepër se një, refuzimi i Porosisë duhet të përmbajë secilen prej tyre.

### **9.5 Përfundimi**

Pasi ONE Albania të ketë përfunduar të gjitha aktivitetet e tij, do të njoftojë AS sipas afatit maksimal të lejuar në SLA standarte. Normalisht, procesi i miratimit do të identifikojë të gjitha arsyet e mos ofrimit të porosisë. Megjithatë, është e mundur që disa ose të gjitha shërbimet e porositura të mos ofrohen pasi Miratimi është pranuar.

#### **9.5.1 Përfundimi me sukses i porosisë**

Të gjitha shërbimet e porositura ishin siguruar me sukses.

Në këtë rast, kërkuesi i Aksesit do të marrë një "Njoftim Përfundimi" me email, menjëherë pasi porosia përfundon në sistemet e ONE Albania.

#### **9.5.2 E padërgueshme**

Porosia nuk është kryer me sukses.

Në këtë rast, Kërkuesi i Aksesit do të marrë Njoftimin "E padërgueshme" me arsyen e saktë, menjëherë pasi porosia është mbyllur (p.sh. refuzuar) në sistemet e ONE Albania.

Për listën e arsyeve të padërgueshmërisë shikoni Aneksin I.

## **9.6 Njoftimi i humbjes**

Me përfundimin e një porosie, ONE Albania do t'i dërgojë Njoftimin e Humbjes operatorit humbës duke e këshilluar atë se e ka humbur shërbimin tek një kërkuar tjetër aksesi.

## **10 Porosia për portën e ndryshimit**

Operatori i LLU jep një porosi CHP për të lëvizur ULMP ose LR e klientit të tij në block and pins të ndryshme. Arsyeja e kësaj lëvizjeje mund të jetë për të ndryshuar inventarin e pasaktë, për t'a nxitur klientin drejt pajisjeve moderne për të siguruar shërbime të shtuara etj.

Për defektet lidhur me kërkesat për ndryshimin e portës, referojuni Seksionit 13.3.2 – Defekti në Bllokun OAO.

### **10.1 Paraqitja e porosisë**

Kërkuarët e aksesit do të dërgojnë porosinë CHP tek AP. Për dërgimin e porosisë, Kërkuarësi i Aksesit duhet:

- Të plotësojë formularin e porosisë me të gjithë informacionin e kërkuar;
- Të bëjë porosinë me email.

### **10.2 Miratimi i porosisë**

AP do të zbatojë të gjitha hapat e vlefshme për të përcaktuar nëse porosia duhet të pranohet / refuzohet. Shembulli i mëposhtëm paraqet këto kontrolle. Lista e plotë është e përfshirë në të dhënat e Kontratës.

AP do të kontrollojë nëse:

- Porosia është përbushur në mënyrë korrekte;
- Telefoni dhe numri i llogarisë përputhen;
- Llogaria është aktive.

### **10.3 Pranimi / Refuzimi i porosisë**

Nëse porosia pranohet, ONE Albania do të këshillojë Kërkuarësin e Aksesit se porosia është pranuar.

Nëse porosia është refuzuar, AP do të lëshojë Kërkuarësit të Aksesit një "Njoftim Refuzimi Porosie" të arsyetuar sipas listës e plotë të arsyeve të refuzimit.

### **10.4 Përfundimi i porosisë**

Klienti është zhvendosur me sukses në një portë të re në bllokun OAO.

Në këtë rast, Kërkuarësi i Aksesit do të marrë një "Njoftim Përfundimi" me email menjëherë sapo porosia të përfundojë në sistemet e ONE Albania.

### **10.5 E padërgueshme**

Porosia e portës së ndryshuar nuk është kryer me sukses.

Në këtë rast, Kërkuarësi i Aksesit do të marrë Njoftimin "E padërgueshme" me arsyen e saktë, me email menjëherë sapo porosia të jetë mbyllur (p.sh anuluar) në sistemet e ONE Albania. Lista e arsyeve të padërgueshmërisë jepet në Aneksin I.

## **11 Lloji i porosisë për linjën e kërkimit LLU**

Operatori LLU jep një porosi ULE në AP në mënyrë që të japë informacion për linjën në adresën e veçantë të një klienti.

Porosia ULE do të ofroje operator LLU me

- Detajet për Centralin Saninë e Linjave Insitu
- Sasinë e linjave Pre Cabled
- Sasinë e linjave të disponueshme rezervë
- Detajet e Sub-Frame

### **11.1 Paraqitja e porosisë**

Kërkuesit e aksesit do të dërgojnë porosinë ULE tek AS. Për dërgimin e porosisë, AS duhet:

- Të plotësojë formularin e porosisë me të gjithë informacionin e kërkuar;

Shënim: Adresa kërkohet kur klienti nuk është aktiv.

- Të bëjë porosinë me email.

### **11.2 Miratimi i porosisë**

AP do të zbatojë të gjitha hapat e vlefshme për të përcaktuar nëse porosia duhet të pranohet / refuzohet. Shembulli i mëposhtëm paraqet këto kontrolle. Lista e plotë është e përfshirë në të dhënat e Kontratës.

AP do të kontrollojë nëse:

- Porosia është përmbushur në mënyrë korrekte;
- Numri i logarisë dhe adresa përputhen;
- Informacioni mbi adresën mund të jepen në formën e adresës së detajuar, si edhe të ARD ID

## **12 Proçesi i njoftimi të humbjes**

AP do të dërgojë Njoftimin e Humbjes Operatorit humbës pas përfundimit të porosisë së LLU.

## **13 Letra për mostransferim**

Me marrjen e njoftimit të Humbjes ofruesi humbës i shërbimit do të ketë mundësinë që ti dërgojë klientit një letër mostransferimi, për ta siguruar atë që transferimi nuk do të bëhet.

Proçesi i Njoftimit të Humbjes nuk mund të përdoret për rimarrje. Me marrjen e Njoftimit të Humbjes, Operatori Humbës I lejohet t'i dërgojë vetëm një njoftim me shkrim klientit.

### **13.1 Qëllimi i letrës anti-slamming**

Është një mënyrë për mbrojtjen e klientëve nga ndryshimet e ULMP, të shërbimeve të paraqitura të LS, ose nga transferimi i lidhjes së tyre nga një operator tek tjetri pa autorizimin apo dijeninë e tyre. Nuk është e detyrueshme për operatorin humbës të dërgojë njërën apo të gjitha këto letra, por është vlerësuar si një mjet i dobishëm për parandalimin e transferimit.

### **13.2 Transferimi i Klientëve**

Nëse klienti ka kontakt me Operatorin Humbës dhe pretendon se transferimi është kryer Operatori Humbës do të ndjekë proçesin e transferimit. Shikoni anekset (TBC) për detaje të proçesit të rimarrjes/transferimit.

### **13.3 Pretendimet për Transferim**

Bazuar në hetimet e kryera, aty ku pretendimi për transferim nuk është i justifikuar, Operatori Humbës duhet të këshillojë përdoruesin fundor. Sidoqoftë, në rastin kur pretendimi për transferim është i justifikuar, Operatori Humbës lëshon një porosi rimarrjeje/transferimi.

### **14 Riparimi I defektit.**

Proçesi i riparimit të defektit është parashikuar në Aneksin C.

#### **14.1 Qëllimi**

Proçesi i riparimit të defektit është i zbatueshëm vetëm për shërbimin ULMP, LS të ONE Albania, ashtu sic janë të përcaktuara dhe në RUO shërbimet 102, 103 dhe 106.

Te gjitha defektet do të raportohen/menaxhohen nga proçesi ekzistues i ULMP për raportimin dhe riparimin e defekteve.

Për qëllimet e proçesit të riparimit të defektit, si qark i rrjetit lokal është përkufizuar fillimi në pajisjet e terminimit të AS në centralin e permutatorit (MDF) të ONE Albania dhe mbarimi tek NTU ose NTP e ONE Albania-it në vend-ndodhjen e klientit.

Kështu qëllimi i shërbimit përfshin defektet në:

1. rrjetin e aksesit lokal të ONE Albania,
2. instalime e brendshme elektrike në adresën e klientit në linjën e NTU ose NTP te ONE Albania,
3. NTU ose NTP e ONE Albania (duke përjashtuar splitter),
4. lidhje jumpers (tel i shkurtër bashkues) në MDF.

Qëllimi i shërbimit përjashton defektet që ndodhin në:

1. furnizimin me energji ose me ajër të kondicionuar në pajisjet e AS të bashkëvendosura ne godinat e fasiliteve të ONE Albania, (referojuni proçesit të defekteve të bashkëvendosjes).
2. defektet ne kabllon lidhëse ndërmjet pajisjes AS dhe bllokut të terminimit të pajisjes AS ne MDF
3. defektet në rrjetin e brendshëm të klientit në pjesën e NTU/NTP të ONE Albania.

#### **14.2 Parimet e raportimit të defektit**

Për shërbimin ULMP përdoruesi fundor do t'i raportojë të gjitha defektet tek AS.

Për shërbimin LS përdoruesit fundorë do të kontaktojnë ofruesin e shërbimit PTSN, ONE Albania, ndërsa AS për defektet në shërbimet e AS.

#### **14.3 Lokalizimi I defekteve**

AS do të jetë përgjegjëse për testimin e parë për të provuar që defekti nuk është në rrjetin e tij. Kërkuesit e aksesit duhet ti ofrojnë ONE Albania rezultatet e testeve të linjave të tyre si pjesë e proçesit dy-ditor të raportimit të defekteve.

Nëse rezultatet e testeve të linjës nuk ofrohen do të aplikohet afati tre ditor i riparimit.

Në mënyrë që të minizohet niveli i jo-defekteve që i janë paraqitur ONE Albania, Kërkuesit e Aksesit duhet të ndjekin proçedurën për lokalizimin e defektit në rrjetin ONE Albania.

Në paraqitjen e defektit te UG, AS do ti kerkohet t'u përgjigjet pyetjeve të mëposhtme:

- a) Punon PSTN?

Vetëm Kërkuesit e Aksesit që rregjistrohen për kushtet dy-ditore të riparimit do të përfitojnë.

AS që nuk është rregjistruar për proçesin dy-ditor të riparimit, do të ndjekë proçesin tre ditor.

- b). A janë testuar pajisjet e centralit?
- c). A është kontrolluar lidhja e brendshme e instalimit elektrik?
- d). A është testuar si duhet broadband CPE?
  - 1 Në rastin e LS, Kërkuesi i Aksesit duhet të testojë shërbimin PSTN duke i telefonuar klientit.  
Nëse shërbimi i zërit i PSTN nuk punon, Kërkuesi i Aksesit duhet të këshillojë klientin të kontaktojë me shërbimin e ONE Albania dhe ta raportojë si defekt të PSTN.
  - 2 Nëse Kërkuesi i Aksesit ende nuk e ka lokalizuar defektin në rrjetin e ONE Albania, duhet të dërgojë teknikët e tij për të kontrolluar pajisjen e DSLAM dhe pajisjet në vendndodhjen e klientit para raportimit si një defekt i Ndarjes së Linjës/ULMP.

#### 14.3.1 Llojet e defekteve:

- **Defekti i PSTN:** Vetëm në rastin e Ndarjes së Linjës. Nëse Kërkuesi i Aksesit nuk mund ta kontaktojë klientin në linjën e dyshuar të defektit, nëse nuk ka ton zileje dhe diagnostikimet shtesë nuk parashtrajnë defect të AS, atëherë AS duhet të këshillojë klientin t'ia raportojë defektin shërbimit (si një defect i PSTN).
- **Defekti i LS:** Nëse Kërkuesi i Aksesit mund të kontaktojë klientin dhe ka kryer të gjitha hapat e mundshme për të lokalizuar defektin në rrjetin e tij (duke përfshirë dhe vendndodhjen e klientit), atëherë duhet të raportohet si defekt i LS
- **Defekti i ULMP:** Në rastin e linjës ULMP Kërkuesi i Aksesit duhet të investigojë rrjetin e tij dhe vendndodhjen e klientit / instalimet e brendshme para se të raportojë defektin në ULMP

#### 14.3.2 Defekti në bllokun OAO:

Operatori LLU operator është duke provuar një defekt në ULMP ose në portën e LS të klientit.

OAO ka konfirmuar defektin në portë. Për këtë arsye, ata i kërkojnë klientit të lëvizë në blloqe dhe pune të ndyshme.

Operatori LLU duhet të raportojë defektin me email me kodin e raportimit të portës së defektit. Porosia do të ndjekë të njëjtën rrjedhë si defektet aktuale, përveç se kur në fushen e komenteve të OAO do të jape detajet e vjetra dhe të reja të block and pins.

#### 14.4 Raportimi i defektit

AS do të raportojë defektet nëpërmjet emailit ose me shkrim.

Shërbimi i shitjes me Shumicë të ONE Albania rezervon të drejtën të kontaktojë AS për të marrë informacione shtesë ose të qartësojë informacionin që është ofruar në raportimin e difektit.

AP refuzon raportin e defektit si të pavlefshëm ose ka tejkalluar qëllimin e përcaktuar, duhet do të ofrohen arsyet për refuzimin.

##### 14.4.1 Orët e raportimit të defektit

Orët e raportimit të defektit janë nga E Hëna deri Të Premten nga ora 08.30 deri 17.30 me përjashtim të festave publike. Raportimet e defekteve, jashtë këtyre orëve do të ruhen për veprim deri në fillimin e ditës tjetër të punës.

## **14.5 Testimi i linjës**

### **14.5.1 Shërbimi i Aksesit te perbashket LS**

Për shërbimin LS, AP do të jetë në gjendje të përdorë pajisjet e tij të testimit të linjës në distancë për të ndihmuar në diagnostigimin e vendndodhjes së defektit.

### **14.5.2 Shërbimi ULMP**

Për shërbimin ULMP pajisja e AP për e testimin e linjës në distancë nuk do të lidhet me rrjetin lokal dhe për këtë arsye AP nuk do të jetë në gjendje ta përdorë atë për të testuar linjën.

### **14.5.3 Karakteristikat e testimit te Linjes**

Lloji i porosisë LLC lejon AS të paraqesë një kërkesë duke përdorur UAN dhe CLI në mënyrë që të bëjë një analizë të detajuar të parametrave te linjës. AP do të bëjë një test të CLI dhe do te informoje AS mbi rezultatet e testit.

## **14.6 Defekti I Jumperit**

Te gjitha testet e linjës do të bëhen me pajisjen e MDF BLOCK të lidhura në anën e centralit të MDF duke siguruar që telat (jumperat) janë testuar gjithashtu. ONE Albania është përgjegjës për instalimin dhe riparimin e telave (jumperit) të MDF.

## **14.7 Defektet në centralit**

Për shumicën e defekteve të diagnostikuara nga AS si në rrjetin lokal, defekti do të jetë aktualisht në rrjetin lokal. Megjithatë për një pjesë shumë të vogël të rasteve defekti do të jetë në kabllin lidhës të pajisjes së AS dhe MDF.

Defekte të kësaj natyre janë të rralla dhe është rënë dakord që AS ta neglizhojë mundësinë e defekteve në kabllin lidhës për defekte që nuk vijnë nga pajisjet e saj.

Nëse AS dyshon se ka defekt në kabllin lidhës do të bëjë një testim të paplanifikuar të kabllit lidhës.

## **14.8 Statusi i defektit**

Kërkuesit e Aksesit mund të ndihmohen nga AP për statusin e defektit

## **14.9 Riparimi i defektit**

Kur defekti është riparuar, AP do të njoftojë AS se defektit është kryer (“Në pritje për tu riparuar”).

AS do të ketë 8 orë kohë (orë biznesi ) me email të tregojë që defekti në linjën e klientit nuk është riparuar

## **14.10 Objektivat për riparimin e defektit**

Objektivat zbatohen për defektet që janë provuar nga DSLAM dhe CPE, të cilat janë pranuar nga ONE Albania.

Objektivat për riparimin e defekteve duhet të jenë sipas standarteve të SLA LLU.



### 14.11 Proçesi i përshkallëzimit

Në rastin e dështimit të proçesit, AS duhet t'u kërkojë ONE Albania një proçes përshkallëzimi për zgjidhjen e shpejtë të problemeve.

Proçesi i përshkallëzimit do të ketë tre nivele të njohura si përshkallëzimi i nivelit të parë dhe të dytë. Shkaqet kryesore të përshkallëzimit janë përshkruar në tabelën 15.2.

**Tabela 15.2: Shkaqet e shkallëzimit të riparimit të defekteve**

Niveli i përshkallëzimit	Shkaku
Niveli i parë i përshkallëzimit	Defekt jo i zgjidhur brenda katër ditëve punë nga raportimi i parë i defektit (ose) Defekt i riparuar nga ONE Albania por AS beson se ka ende një defekt në rrjetin ONE Albania.
Niveli i dytë i përshkallëzimit	Defekt jo i zgjidhur brenda pesë ditëve punë nga raportimi i parë i defektit (ose) Defekt i riparuar nga ONE Albania por AS beson se ka ende një defekt në rrjetin ONE Albania.
Niveli i tretë i përshkallëzimit	Defekt jo i zgjidhur brenda gjashtë ditëve punë nga raportimi i parë i defektit (ose) Defekt i riparuar nga ONE Albania por AS beson se ka ende një defekt në rrjetin ONE Albania.

Për të qenë sa më efektiv proçesi i përshkallëzimit emrat dhe numrat e kontaktit të pikave të përshkallëzimit duhet të shkëmbehen ndërmjet AS dhe AP.

Përshkallëzimet duhet të jenë në nivele të barabarta.

### 14.12 Mosmarrëveshjet

Nëse Kërkuesi i Aksesit konsideron se një difekt nuk është riparuar, ose kur nga testimi i AS vihet re voltazh i huaj në linjë, AS duhet të shkojë në vendndodhjen e klientit, të kontrollojë CPE dhe të kryejë testime fund me fund para se të ri-regjistrojë raportin e defektit.

Në të gjitha fazat, kërkuesi i aksesit mund të kërkojë një proçes përshkallëzimi të detajuar si më lartë. ONE Albania dhe Kërkuesi I Aksesit duhet të ndërveprojnë aktivisht për të zgjidhur defektin nëse ekziston dyshimi se defekti është në rrjeti e ONE Albania.

### 14.13 Dyshimi I ndërhyrjes në linjë

Plani I menaxhimit të frekuencës së linjës së bakrit (CLFMP) përcakton teknologjitë që mund të vendosen nga Kërkuesi i Aksesit mbi rrjetin ONE Albania. Kur ka dyshime mbi një kërkues aksesi se në rrjetin e tij ka ndërhyrje, CLFMP i detajon Kërkuesit të Aksesit proçesin e raportimit të dyshimeve. Meqënëse, pritshmëria e situatave të tilla është e shumë e ulët, proçesi i zgjidhjes do të shtrihet jashtë standarit të proçesit të riparimit të defektit.

## **15 Faturimi**

### **15.1 Hyrje**

ONE Albania do të faturojë AS për shërbimet LLU në përputhje me kushtet e RUO dhe në përputhje me Listen e cmimeve.

### **15.2 Raporti i përdorimit**

ONE Albania do të japë një faturë të detajuar për të shoqëruar çdo faturë përmbledhëse. Kjo do të tregojë ndryshimet për Ofrimin e Shërbimit dhe proceset e Riparimit të Defektit. Operatorët do të marrin faturë përmbledhëse mujore dhe faturë detajuar. Megjithatë, nëse kërkohet ONE Albania do të postojë faturën përmbledhëse.

#### **15.2.1 Përmbajtja e raportit të përdorimit**


##### **15.2.1.1 Ofrimi i shërbimit**

ONE Albania do të faturojë porositë për shërbimet e ofruara bazuar në strukturën e faturimit dhe në masën e faturës sic është parashikuar në RUO dhe Listen e cmimeve. Raporti i përdorimit do të rendisë çdo porosi sipas numrit të saj të referencës dhe datës së përmbushjes së porosisë dhe do të specifikojë çdo faturim të saj.

##### **15.2.1.2 Riparimi i defektit**

ONE Albania do të faturojë raportimet e plota të bazuar në strukturën e faturimit dhe në masën e faturës sic është parashikuar në RUO. Raporti i përdorimit do të rendisë çdo defekt sipas numrit të raportit të defekteve të ONE Albania dhe datës së përmbushjes dhe do të specifikojë çdo faturim të saj.

**Aneksi A – Ecuria e ofrimit të shërbimeve**  
**Llojet e porosisë: Ofrim/Ndërprerje**




Ecuria e procesit të sigurimit të shërbimit

Llojet e porosisë:

Ofrim


Ndërprerje







**Aneksi B – Ecuria e e ofrimit të shërbimit  
Lloji i porosisë: Anullim**

**Ecuria e ofrimit të shërbimit  
Lloji i porosisë: E anuluar**



### Aneksi C – Ecuria e procesit të riparimit të defektit








## Aneksi D– Kodet e riparimit të defektit

Më poshtë është dhënë një listë e kodeve për riparimin e defekteve kryesore, të cilat mund të raportohen nga ONE Albania tek një Kërkues Aksesi për llojin e kodit të riparimit për një defekt në LLU.

kodi	Përshkrimi	kodi	Përshkrimi
A	E rregulluar	DS	Dëmtuar nga stuhia
C	E ndyshuar	DZ	Dëmtuar nga siguresa e klientit
CB	Ndryshon kabina telefonike	FP	Plani kryesor CBL
CC	Ndryshim i çiftit të kablove	I	I ndërprerë
CI	Instrument i ndyshuar nga tekniku	L	Dëmtim ndricimi
CL	Ndyshim për arsye ndricimi	NT	Nuk ka ende magazinë në dispozicion CT
CP	Instrument i ndryshuar nga dispatçeria qëndore	P	Pemë të prera
CR	Instrument i ndryshuar nga agjenti	R	I riparuar
CX	Ndryshim i PBX/PABX (ende jo në përdorim)	T	Përkohësisht OK
D	Dëmtim nga armë zjarri	E	Ri-instaluar
D3	Dëmtuar nga palë e tretë	EL	E pastruar ndërkohë që lokalizohet


**Aneksi F – Ecuria e procesit të sigurimit të shërbimit  
Lloji i porosisë kthen LS në ULMP**



Ecuria e procesit të sigurimit të shërbimit  
Llojet e porosisë:  
Ndryshim i LS në ULMP

Statusi i porosisë:  
I përfunduar  
I padërguar

OAO porosi e origjinuar



## Aneksi G – Shembulli i njoftimit të pranimit/ refuzimit të fshirjes manuale të LLU

### Shembulli i njoftimit të anulimit të LLU

Tipi i porosisë

LLU Nr. I Referencës së porosisë

AP numër porosie

E pranuar ose refuzuar

Arsyeja e refuzimit

Data e dërgimit

**Aneksi H- Formulari i porosisë NTU**

<b>ALBTELECOM NTU DHE FORMULARI I POROSISE SE INVENTARIT</b>			
<b>SPLITTER</b>			
Kërkuesi i aksesit: Emri i kontaktit	<input type="text"/>	Totali i NTU-ve të marra këtë muaj :	<input type="text"/>
	<input type="text"/>	Totali i NTU-ve aktualisht ne stok:	<input type="text"/>
		Totali i defekteve të NTU-ve këtë muaj:	<input type="text"/>
Numri i Kontaktit	<input type="text"/>	Totali i NTU te kerkuara per muajin tjetër	<input type="text"/>
		Totali i splitters të marrë këtë muaj:	<input type="text"/>
E-maili i kontaktit	<input type="text"/>	Totali i Splitter stok aktualisht:	<input type="text"/>
Adresa e dërgimit	<input type="text"/>	Totali i defekteve në Splitter këtë muaj	<input type="text"/>
		Totali i Splitter që kërkohen për muajin tjetër	<input type="text"/>
Data	<input type="text"/>		
E Kërkuar me datë:	<input type="text"/>		

## Aneksi I – Arsyet e refuzimit dhe mosdërgimit

<b>Mesazh refuzimi</b>	<b>Kuptimi/ Përdorimi</b>
Shërbim i padisponueshëm	Kur linja dështon në testim, nuk ka rrugëzim
B&P të pasakta	AP gjen të dhënat e porosisë për bllokun dhe çiftin si jo/jo të përshtatshme/jokorrekte
Asnjë linje rezervë e disponueshme	Linja e bakrit nuk ofron mundësi për rezerva
Klient i padisponueshëm	Klienti i AS nuk mund të kontaktohet nga AP për të arranzhuar nje vizite ne vend.
Shërbim i refuzuar nga klienti	Klienti i kontaktuar nga AP, me telefon ose në vendbanimin e tij, informon AP se nuk e dëshiron shërbimin

## **Aneksi J – Përrjashtimet & shërbimet konkurruese**

### **Përrjashtimet**

Rregulloret e aksesit sigurojnë për hapjen e të gjitha rrjeteve lokale ekzistuese dhe të ndonjë çifti rezervë në impiantin e aksesit të rrjetit.

Megjithatë, rrjeti lokal me disa facilitete/shërbime nuk do të jetë i hapur.

Janë dy lloje:

1. Linjat me shërbime/ facilitete që duhen të përrjashtohen nga shërbimi LLU për shkak të papajtueshmërisë aktuale teknike me shërbimin LLU.
2. Rrjete lokale me shërbime/ facilitete që janë përrjashtuar nga RUO aktuale e ONE Albania. Për më tepër, ka disa përrjashtime dhe rrethana të veçanta ku ofrimi i një shërbimi të LLU mund të devijojë nga proçeset standarte.

### **Përrjashtimet për shkak të papajtueshmërisë teknike aktuale**

#### **1. LS dhe matësi privat i pajtimtarit**

Matësi privat i pajtimtarit duhet të hiqet nga linja përpara se të bëhet porosia për LS

#### **2. ISDN dhe shërbimi LS**

Porositë e LS me ISDN nuk do të pranohen.

#### **3. ISDN dhe shërbimi ULMP**

Klienti do të humbasë shërbimin ISDN si pasojë e porosisë për ULMP. Kur paraqitet një porosi për hapjen e linjës ISDN, duhet të paraqitet numri kryesor i instalimit të ISDN. Porositë për numra ndihmës ose për një numër pjesë e një serie DDI do të refuzohen.

#### **4. Hunting dhe shërbimi ULMP**

Hunting duhet të hiqet para se të paraqitet një porosi për ULMP. Për këtë arsye, është rënë dakord që kërkuesi i aksesit duhet ti kërkojë përdoruesit fundor të kontaktojë me ONE Albania për të reflektuar këtë ndryshim para se porosia e ULMP të paraqitet për rrugëzim. Heqja e Hunting nuk duhet të zgjasë më tepër se pesë ditë.

### **Shërbimet konkurruese**

1. CPS
2. Bitstream

Aneksi K – Formulari i porosisë me të dhënat kryesore

TESTIMI I LINJES KRYESORE – TË DHËNA FORMULAR KËRKESË – POROSI	
Email tek: <a href="mailto:wholesale@Albtelecom.al">wholesale@Albtelecom.al</a>	
Kerkuesi i aksesit :	<input type="text"/>
Emri i kontaktit:	<input type="text"/>
Numri i kontaktit :	<input type="text"/>
Emaili i kontaktit	<input type="text"/>
Adresa e dërgesës :	<input type="text"/>
Data e porosisë:	<input type="text"/>
Porosi e dhënë nga	<input type="text"/>
CD për Muajin Kalendarik:	<input type="text"/>



